



## In medias res

### **Të krijojmë një shoqëri miqësore për fëmijë”**

*“Në qoftë se do të mblidhnim lotët e fëmijëve në të gjithë botën, do të krijohej një liqen i madh, nga i cili do të prodhohej energji, por çmimi i saj do të ishte shumë i lartë”*

*Xhani Rodari*

Shoqëria kosovare, si shoqëri që është në zhvillim e sipër duhet ti kushtoj rëndësi të madhe respektimit të të drejtave të njeriut/fëmijës. Kjo mund të arrihet përmes edukimit. Në këtë aspekt, për shkak të zhvillimit individual dhe të përgjithshëm, të gjithë fëmijët duhet ta mësojnë dhe kuptojnë konceptin e të drejtave të njeriut, të dinë se cilat të drejta iu takojnë dhe të bëhen të vetëdijshëm për veten dhe shoqërinë.

Të drejtat elementare të njeriut-respekti ndaj jetës së çdo individi dhe dinjiteti njerëzor-nuk mund të blihen, të fitohen ose të trashëgohen. Ato janë të patjetërsueshme, për çdo qenie njerëzore, pa dallim race, ngjyre, seksi, gjuhe, religjioni, përcaktimi politik apo ndonjë përcaktim tjetër, origjinë nacionale apo shoqërore, pasuri, prejardhje ose ndonjë status tjetër.

Ndërtimi i kulturës së të drejtave të njeriut/fëmijës, kërkon nga njerëzit që ti njohin të drejtat dhe detyrat e veta e po ashtu të dinë si ti mbrojnë ato.

Shkolla paraqet mjedisin më të përshtatshëm, ku mund të fillojë formimi i vetëdijes për të drejtat e fëmijëve dhe krijimi i kushteve për zbatimin e tyre të përditshëm. Secili ka të drejtë të arsimohet. Arsimimi është i orientuar drejt zhvillimit të plotë të individit dhe forcimit të respektimit të të drejtave të njeriut/fëmijës dhe lirive elementare.

Mësimdhënësi çdo moment duhet të jetë i vetëdijshëm për të drejtat e fëmijës dhe ti respektojë ato në kontekst të sjelljes dhe veprimit të tij të përgjithshëm, e jo vetëm si pjesë e mësimi që zhvillohet ose si pjesë e përmbajtjes që duhet të përvetësohet.

Në përvetësimin e lëndës për të drejtat e fëmijës, nuk ka përgjigje të gabuar apo të saktë. Çdo mendim dhe ide është e mirëseardhur dhe duhet doemos ti kushtohet kujdes. Çdo lëndë përjetohet dhe praktikohet. Nuk duhet të mësohet përmendësh dhe as nuk duhet që nxënësit të vlerësohen. Çdo fëmijë duhet ti lihet hapësirë dhe kohë e nevojshme që të mund të shpreh mendimin e vet dhe të marrë pjesë aktive me qëndrimet dhe me pikëpamjet e veta.

Qëllimi kryesor i programit “Edukimi për të drejtat e njeriut/fëmijës”, është, që fëmijët të kuptojnë se ajo që iu nevojitet dhe atë që e duan, janë të drejtat e tyre dhe për këto vlen të angazhohet, pasi që të drejtat duhet të kërkohen dhe mbrohen prej tyre.

Me gjithë avancimet dhe përparimet e bëra në fushën e të drejtave të fëmijës në Kosovë, mbetet ende shumë për të bërë. Nxënësit në Kosovë nuk kanë një edukim cilësor që mundëson zhvillimin maksimal të tyre, fizik dhe shpirtëror.

Dhuna mbi fëmijë, është ende në masë të pa tolerueshme. Partneriteti ndërmjet Institucioneve që merren me edukimin e të drejtave të fëmijës, nuk është në nivelin e duhur. Andaj, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), përmes shumë projekteve të cilat ndërliken në mënyrë funksionale me të drejtat e fëmijës, është duke u angazhuar për krijim të një fryme të re në Kosovë, duke kontribuar në formimin e një shoqërie mike për fëmijë në të cilën fëmijët do të jenë në qendër.

Te drejtat e njeriut/fëmijës u takojnë të gjithëve.

*Shkroi: Ardita Kabashi-Hima*

## Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

### **Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH**

■ Në kuadër të Programit të MKLSH më 24-25 shkurt në Gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë është mbajtur seminari i katërt me titull “Teknika për zhvillimin e mendimit kritik”.

### **Strategjitë e reja të mësimdhënies dhe të nxënit**

■ Edhe pse projekti i financuar nga Banka Botërore “Strategjitë e reja të mësimdhënies dhe të nxënit” ka përfunduar në nëntor të vitit 2006, disa mësimdhënës të pakënaqur me faktin se kanë përfunduar vetëm 6 nga 8 modulet e programit “Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit” kanë shprehë interesim që me vetëfinancim të vazhdojnë deri në fund programin e trajnimit. Kështu 104 mësimdhënësit e Prishtinës, Prizrenit, Xërxës dhe Kamenicës që morën pjesë në seminarin e 6 në janar, vazhduan seminarin e 7 me titull “Krijimi i lexuesve mendimtarë” gjatë muajit shkurt. Për shkak të problemit teknik në grumbullimin e të hollave, trajnimi i 29 mësimdhënësve të shkollave në Cërmjan të komunës së Gjakovës do të organizohet gjatë muajit mars.

### **EKK (Edukimi kundër korrupsionit)**

■ Gjatë muajit shkurt janë organizuar disa trajnime në kuadër të programit EKK. Kështu trajnimi i filluar më 27 janar në Mitrovicë dhe Suharekë u vazhdua më datat 3-4 shkurt. Nga fletët e vlerësimit shihet se mësimdhënësit kanë qenë të

kënaqur me programin e trajnimit, përgatitjen e trajnerëve dhe organizimin e trajnimit. Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit u njoftuan se do të monitorohen në klasat e tyre.

■ Po ashtu në kuadër të këtij programi është mbajtur trajnimi në Podujevë më 10, 17 dhe 18 shkurt, si dhe në Gjakovë më 17, 24-25 shkurt. Është evidente se në këto trajnime morën pjesë një numër më i vogël i mësimdhënësve se që ishte paraparë. Mungesa e mësimdhënësve në trajnim është pasojë e neglizhencës së përfaqësuesve komunal të arsimit të këtyre komunave për të informuar pjesëmarrësit në trajnim.



■ Më 24 shkurt u mbajt trajnimi për 35 mësimdhënës të komunës së Shtimes. Pjesa e dytë e programit 3-ditor do të vazhdojë më 3-4 mars 2007.

### **Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin**

■ KEC në bashkëpunim me Agjencionin Anti-Korrupsion (AAK) ka filluar implementimin e programit “Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin”, të cilin e financon ATRC në bashkëpunim me IREX dhe USAID. Gjatë muajit shkurt është finalizuar trajnimi në Gjilan, i cili kishte

filluar në muajin janar. Po ashtu gjatë këtij muaji janë organizuar dhe 2 trajnime 2-ditore në Drenas dhe Pejë. Trajnimi në Drenas është mbajtur më 21-22 shkurt në lokalet e shkollës fillore "Ali Gashi", ndërsa në Pejë më 27-28 shkurt në lokalet e Qendrës Didaktike. Pjesëmarrës në trajnime kanë qenë zyrtarë të institucioneve qendrore dhe lokale, përfaqësues të komunitetit, liderë partiak, përfaqësues të shoqërisë civile, të organizatave rinore etj. Nga fletë vlerësimet shihet se pjesëmarrësit kanë qenë të kënaqur me programin e trajnimit dhe përgatitjen e trajnerëve.

## **Edukimi për të Drejtat e Fëmijës**

■ Librat të cilat janë botuar në bashkëpunim me ABA-CEELI-n, janë shpërndarë në të gjitha shkollat fillore të Kosovës. Monitorimin për përdorimin e këtyre librave, kanë filluar ta bëjnë ZRA dhe DKA në Rajonet përkatëse. Gjatë këtij muaji, ashtu siç ishte e planifikuar më parë, KEC, respektivisht programi „Edukimi për të drejtat e fëmijës“, ka filluar edhe hulumtimin ku fokus në këtë hulumtim janë vërejtjet dhe sygjerimet e mësimeve për këta tre libra. Muaji mars është muaji kur edhe do të bëhet raporti narrativ i këtij aktiviteti nga KEC për ABA CEELI-n.

■ Me 26.02.2007, Aba Ceeli në bashkëpunim me KEC, përsëri ka organizuar një seancë gjyqësore. Këtë herë në Komunën e Pejës me nxënës të klasave të nënta dhe të dhjeta, ku nxënësit do të kenë mundësi që më afër të njihen me ligjin për të miturit, si dhe për pasojat e fëmijëve nëse bien në kundërshtim me ligjin.

■ Duke pasur parasysh se muaji mars është muaj i disa festave, programi "Edukimi për të drejtat e fëmijës" do të përgatis një program festiv me nxënësit e

shkollës Jo publike „Mileniumi i Tretë“. Ky program do të organizohet në bashkëpunim me shkollën e Kitarës „Vihuela“. Programi festiv do të mbahet më 6 Mars, në sallën e Teatrit Dodona, duke filluar në orën 16.00. Nxënësit e shkollës „Mileniumi i Tretë“ do të marrin pjesë me tri recitale, në të tri gjuhët (shqipe, angleze dhe gjermane), e po ashtu edhe me disa pika këndimi dhe instrumentale.



■ Më 23 02 2007, kemi organizuar edhe një shfaqje për të miturit të cilët gjenden në „Shtëpinë Korrektuese“, në Lipjan. Kjo shfaqje u organizua me ndihmën e Sokol Plakolli, Aktor, themelues i studios së aktrimit për fëmijë dhe të rinj „Filizat“ në kuadër të AYA-ARSH „Pjetër Bogdani“ si dhe po ashtu me iniciativën e stafit profesional të Teatrit Dodona. Mesazhet që jep kjo shfaqje me fund tragjik ishin të shumta si: Lufta kundër dukurive të dëmshme shoqërore; droga, sida, prostitucioni, mos vijimi i rregullt i mësimet nga të rinjtë, dhe si rrjedhojë, pasojat që do ti kenë ata që shkojnë nëpër një rrugë të tillë.

■ Hulumtimi për Paragjykimet dhe Stereotipat gjinore, është në përfundim e sipër. Sipas marrëveshjes me organizatën në bashkëpunim, këto materiale duhet të dorëzohen gjatë muajit mars 2007. Në Qershor të këtij viti është planifikuar botimi i tyre.

---

## Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit shkurt programi Hap pas Hapi ka mbajtur një seri trajnimesh që janë vazhdimësi e trajnimeve të filluara në shtator të vitit të kaluar. Prej 8 trajnimeve të mbajtura 5 ishin trajnime avancuese për klasën e parë: një për mësuesit e regjionit të Podujevës, një për mësuesit e regjionit të Mitrovicës, 2 për mësuesit e regjionit të Gjakovës dhe një për mësuesit e regjionit të Pejës.



■ Po ashtu gjatë muajit shkurt janë mbajtur dy trajnime avancuese për parashkollëre ku një ishte për edukatorët e regjionit të Pejës ndërsa tjetri për edukatorët e kopshteve të Kosovës. Trajnimi i 8 ishte trajnim për klasën e dyte. Të gjitha trajnimet janë mbajtur nga trajnerë vendore dhe siç shihet nga vlerësimet ishin të suksesshme.

■ Me datën 15 shkurt u mbajt takimi me personat kontaktues të kopshteve të Kosovës ku u diskutua dhe u mbajtën aktivitete për dëgjimin konstruktiv si dhe u diskutua për projekt temat të cilat po kanë sukses në disa kopshte të Prishtinës.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*